

VENDIM
Nr.993, datë 10.12.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI DHE
ASFALTIMI I RRUGËS “BADELONJË E RE – PETRAN”, NË KOMUNËN PETRAN, NË
QARKUN E GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni dhe asfaltimi i rrugës “Badelonjë e Re – Petran”, në komunën Petran në qarkun e Gjirokastrës.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të komunës së Petranit.

3. Pronarët e pasurive që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, dhënë në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 300 (treqind) m² tokë truall, në vlerën e përgjithshme të shpronësimit 240 000 (dyqind e dyzet mijë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e komunës së Petranit, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga komuna e Petranit.

7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga komuna e Petranit, për realizimin e këtij projekti.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë 300 (treqind) m² tokë truall, shpronësuar në favor të komunës së Petranit, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna e Petranit për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË
SHPRONËSOHEN PËR RIKONSTRUKSIONIN DHE ASFALTIMIN E RRUGËS “BADELONJË E
RE-PETRAN”, NË KOMUNËN PETRAN, GJIROKASTËR

Nr.	Emër, mbiemër	Sip.m ² truall	Çmimi lekë/m ²	Vlera lekë	Dok. i pronësisë	Zona kadastrale
1.	Ylli Njazi Makollari	300	800	240 000	Certifikatë	1071
	Totali			240 000		